


KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 568/118 Data 06.12.19
PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitroviica - Municipality of Mitroviica South



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Ndërmarrja Publike "Qendra Multifunkionale" SHA

11. PROTOK. 16/10

MEMORANDUMI I MIRËKUPITIMIT

NË MES TË

QENDRËS MULTIFUNKSIONALE "OMNI SPORT" NË
MITROVICË

DHE

KOLEGJIN "BIZNESI" NË PRISHTINË

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi

1. Qendra Multifunktionale në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson z. Nusret Çubreli – Kryeshef Ekzekutiv
2. Kolegji Universitar Biznesi, të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan,

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum mirëkuptimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Qendra Multifunktionale “Omni Sport” në Mitrovicë dhe Kolegji Universitar “Biznesi”, pajtohen që për tri vite (tri vite akademike) t’i realizojnë konform mandatit dhe kompetencave ligjore.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Qendra Multifunktionale në Mitrovicë do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në aktivitetet e marketingut për realizimin e misionit të saj, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Qendra Multifunktionale në Mitrovicë është e gatshme, sipas mandatit të saj, të ndihmojë në marketing dhe promovimin e programeve studimore të fakultetit sipas kërkesës së Kolegjit “Biznesi”.
3. Qendra Multifunktionale në Mitrovicë do të ju mundësojë studenteve të Kolegjit “Biznesi” zhvillimin e praktikës në kuadër të qendrës pa pagesë.
4. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Qendrën Multifunktionale “Omni Sport” në Mitrovicë në aspektin e mbrojtjes së zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet.
5. Kolegji Biznesi do të mbështesë Qendrën Multifunktionale “Omni Sport” në Mitrovicë me stafin e saj akademik, për ligjërata nga lëmia: emerxhencave, ekonomisë dhe jurisprudence-sipas nevojave që paraqet Qendra Multifunktionale “Omni Sport” në Mitrovicë.

Neni 4
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit


Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6
Hyrja në fuqi


Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji Universitar Biznesi


Dekani
Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/

Qendra Multifunktionale
Kryeshf Ekzekutiv


SH.A.
QENDRA MULTIFUNKSIONALE
Nusret Cobreli

Nënshkruar në Mitrovicë, me datë 30.11.2018

